



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1027

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Rinori Tours SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të Komuna e Klina në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ri tender – Transporti i nxeneseve të shkollave Fillore të Mesme të uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit: 634-25-8397-2-2-1, me 24/11/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Rinori Tours SH.P.K. me nr. 2025/1027, e datës 16/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ri tender – Transporti i nxeneseve të shkollave Fillore të Mesme të uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit: 634-25-8397-2-2-1.
2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, ndërkah aktiviteti i prokurimit Ri tender – Transporti i nxeneseve të shkollave Fillore të Mesme të uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit: 634-25-8397-2-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Rinori Tours SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 12/09/2025, Komuna e Klina në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ri tender – Transporti i nxeneseve të shkollave Filllore të Mesme të uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit: 634-25-8397-2-2-1.

Ndërsa me datën 09/10/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer Operoret Ekonomik Gjafa Travel SH.P.K. & Dita Travel SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 42,550.00 €

Me 13/10/2025, OE Rinori Tours SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16/10/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Rinori Tours SH.P.K. me nr. 1027/2025 lidhur me aktivitetin Ri tender – Transporti i nxeneseve të shkollave Filllore të Mesme të uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit:634-25-8397-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Rinori Tours SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1. Grupi O.E Xhafa Travel nga Klina dhe Dita Travel shpk nga Podujeve nuk e kanë Formularin standard të Krijimit të Grupit .

Ne formularin e dërguar në faqe 2 janë të tjerë anetar , Pika 6 Ne të gjithë anetaret e grupit ‘konfirmojm përgjegjësit e secilit anetar

Ketu nuk jane Anetaret e grupit Xhafa Travel nga Klina me Dita Travel shpk nga Podujeva por keta :

a-Mendi invest Shpk.....

b. Ideor Construction.....

Do te thot te tjere anetar te Konzirciumit

A/K. Eshte dashur ta Vleresoj te papergjegjeshem Oferten e Grupit O.E ,Xhafa Travel nga Klina dhe Dita Travel shpk nga Podujeva pasiqe Ky eshte kusht administrativ .

A.K. ne Vendimin e Kerkeses per Ri vleresim Konstaton dhe pranon se eshte “ gabim teknik “ A.K. nuk ka respektuar nenein 59 Vleresimi , krahasimi i tendereve , perkatesisht nenin 69 kapacitetit teknik profesional .

Pretendimi 2 Grupi I O.E i propozuar me kontrat nuk ka plotesuar kerkesen nga pika 69 te LPP Kapaciteti teknik profesional. Kërkesa - Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne periushen e 36 muajeve te fundit para dates se publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 63.825.00 Euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve. Dëshmi Kontrata të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare duke bashkëngjitur listen, kontrata, referenca dhe procesverbalet e pranimit teknik të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve. Grupi i O.E Xhafa travel nga Klina dhe Dita travel shpk nga Podujeva kane preytuar Referenc nga Shkolla FMU Ujmir ne vlere 10.000.00 Euro ne emer te Kontrates nr.03-2024 vlere totale 8.189, 00 € Prokurimi 634-23-12308-211 e Cila kontrta eshte e lidhur ne mes Komunes Kline dhe O.E Arijani Tours nga Klina per lot 4. Andaj Kjo referenc nuk mund te pranohet meq ne kontrate nuk eshte i gjetur emri ie Xhafa Travel . 7/4 A.K. Komuna Kline nuk mund ta pranoj kete referenc si te qendrueshme pasi Kontrta eshte me Arijani Tours e jo me Xhafa Travel. A.K. ne Vendimin kunder kerkeses per Ri shqyrtim konstaton se nuk eshte marr per baze kjo Referenc (derisa per ne eshte dokument jo korrekt I keqperdorur nga Drejtoria e shkolles) 8/4 Shiko referencen . Per me teper as qe eshte e ngarkuar Kontrata , Mungon Regjistri i kontrtve dhe kontrtata ne emer te Xhafa Travel. G.O.E , Xhafa travel dhe Dita travel shpk kane perzentuar referencen nr 489/24 te dates 10.10.2024 nga Medresa Alaudin per sherbime ne emer te Dita travel shpk per tri vite 2021-2022 dhe 2023, ku eshte e potencur vlera per tri vite ne vlere 71.400.00 euro ,derisa per nje vite eshte e shprehur ne vlera per vite 23.800 , 00 euro Kesisjoj nga kjo deshmi nese hiqen vitet 2021 dhe 2022 vlerat per keto dy vite ne vleren prej 47.600,00 euro mbetet vlera prej 23.800 euro Dhe Kontrata tjeter per vitin 2024 ,e lidhur me daten 10.10.2024 me SHML Medresja Alaudin pa vler te pergjitheshme e nese shihen pozicionet 182 nxenes me vleren 140 euro vlera e kontrates do te ishte 25.480.00 euro ku nuk jane transport por akomodim ne hotel per kater bujtje . Edhe nese mirret Kjo kontrate (edhe pse nuk eshte e natyres se njejt -transport I udhetareve - vlera e teresishme do te ishte 49.280.00 Euro . Pra jo vlera e kerkuar minimum 63.825.00 Euro 9/4 Dhe ne Perfundim Permbushja e Kriterit te Kerkuar Kontrata te perfunduara ne periudhen trevjeqare 2022-2023-2024 (36 muajt e fundit 30-08 .2022 – 30.09.2025) ne vleren prej 63.850 Euro nuk eshte e plotesuar Nuk ka Regjister te Kontrtave dhe nuk eshte e permbushur Kerkesa nga FDT e as Dosjes se tenderit 10/4 A. K.ne Vendimin per Kerkesen per Ri Shqyrtim ka thene se jane plotesuar kerkesat per Pune te kryera ,

gje qe nuk rezulton shikuar faktet .Per me teper Kontrata e lidhur me date 10.10.2024 nuk eshte e perfshir ne Referencen e dhen nga Medresaj Alaudin e dates 10.10.2025

Pretendimi 3 . A.K. Komuna Kline ka pranuar dokumentet qe nuk jane ne harmoni njera me tjetren . Libreza e autobusit te Xhafa Travel me tabelen 03-661-IH nuk ka certifikat te kontrolles teknike .Certifikata eshte per Automjetin 03-590- IT E as njeri nuk kan polisen e sigurimit . 11/4 12/4 13/4 Derisa Anetari I dyte Dita Travel shpk nga Podujeva nuk ka prezentuar Certifikatat e Kontrolles teknike por ka dhene nje deklarate te perpiluar nga vete Operatori qe nuk ka relevance , Shikuar Udhezimin Administrativ nga MMPHI nr 10/2022 te dates 30.12.2022 ku neni 19 pika 1.2 percakton qe mjetet qe bejn transportin e njerezeve jane te obliguar qe Kontrollat teknike te automjetit te behen Cdo 6 muaj . Ky Udhezim ka per baze Ligjin nr 05/L-132 .

Pretendimi 4. Operatori Ekonomik Lideri nuk ka prezentuar Certifikatat shendetesore siq parashihet per Vozites te Autobusave por ka prezentuar nga QKMF Nene Tereza Kline form jo zyrtare . 14/4 Shiko . 15/4 Kjo eshte forma zyrtare (shembull)

Pretendimi 5. Anetari I dyte e konzorciumit Dita Travel nuk ka deshmi te vertetimit nga Gjykata kerkes nga Neni 65 I LPP per pranueshmeri Perfundim Kerkojm nga OSHP qe te Aprovoj Teresisht Ankesen tone dhe marr Vendim 1. Te Anuloj Vendimin per shperblim me kontrat te datës 09.10.2025

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17/10/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1027/2025, ndërsa me datë 28/10/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 1027/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Rinori Tours SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1027 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Klinës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë- lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 42,550.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 65, dhe 69 të LPP-së, si dhe shkelje të dispozitave të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht të nenit 26.6 të Rregullores.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës konkretisht kundër ofertës së GOE të rekomanduar për kontratë, ndërsa oferta e OE ankues është shpallur e pasuksesshme. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë

shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë Xhafa Travel nga Klina dhe Dita Travel shpk nga Podujeve nuk e kanë Formularin standard të Krijimit të Grupit. Në formularin e dërguar në faqe 2 janë të tjerë anëtar, Pika 6 Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë përgjegjësit e secilit anëtar, këtu nuk janë anëtarët e grupit Xhafa Travel nga Klina me Dita Travel shpk nga Podujeva por këta OE Mendi invest Shpk dhe Ideor Construction, që do të thotë të tjerë anëtar të konzorciumit, AK është dashur ta vlerësojë të papërgjegjshëm ofertën e Grupit OE Xhafa Travel nga Klina dhe Dita Travel shpk nga Podujeva pasi që ky është kusht administrativ. AK në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim ka pranuar se është “gabim teknik”. AK nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së. OE ankues me ankesë ka bashkangjitur këtë Marrëveshjen për themelimin e grupit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të ofertës së grupit të OE të rekomanduar për kontratë, përkatësisht dokumentit me titull “3.1.KONZORCIUMI DHE DEKLARATA.pdf”, sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë në pikën 6 të kësaj marrëveshje ka përfshirë dy operator ekonomik të cilët nuk janë pjesë e kësaj marrëveshje. Në këtë dokument, pika 5, anëtarët e grupit që lidhin marrëveshje janë “Gjafa Travel” Sh.p.k. dhe “Dita Travel” Sh.p.k. Kurse, në pikën 6 të kësaj marrëveshje ku konfirmohet përgjegjësia e secilit anëtar, janë dy operator tjerë ekonomik, “Mendi Invest” Sh.p.k. dhe “IdeorConstruction” Sh.p.k..

Meqenëse kjo marrëveshje ka gabime, ku janë përfshirë emra të operatorëve tjerë ekonomik dhe të cilët nuk janë pjesë e grupit, atëherë duke u bazuar në “UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK”, fq. 41, jepet udhëzimi që tenderi duhet refuzuar. Për më shumë, referoju pjesës së shkëputur nga tabela e udhëzuesit:

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën nga Kapaciteti teknik profesional, nenin 69 të LPP-së.

Kërkesa - Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme në periudhën e 36 muajve të fundit para datës së publikimit të njoftimit për kontratë në vlerën prej se paku 63.825.00 Euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve.

Dëshmi Kontrata të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare duke bashkëngjitur listën, kontrata, referenca dhe procesverbalet e pranimit teknik të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve.

GOE i rekomanduar për kontratë Xhafa travel nga Klina dhe Dita travel shpk nga Podujeva kanë prezantuar Referencë nga Shkolla FMU Ujmir në vlerë 10.000.00 Euro në emër të kontratës nr.03-2024, vlerë totale 8.189, 00 € Prokurimi 634-23-12308-211 e cila kontratë është e lidhur në mes Komunës Kline dhe O.E Arijani Tours nga Klina për lot 4. Andaj kjo referencë nuk mund të pranohet meqë në kontratë nuk është i gjetur emri i Xhafa Travel AK nuk mund ta pranojë këtë referencë si të qëndrueshme pasi kontrata është me Arijani Tours e jo me Xhafa Travel. AK në vendimin kundër kërkesës për ri shqyrtim konstaton se nuk është marrë për bazë kjo referencë (derisa për në është dokument jo korrekt i keqpërdorur nga Drejtoria e shkollës).OE ankues me ankesë ka bashkangjitur këtë referencë. Për më tepër as që është e ngarkuar Kontrata, Mungon Regjistri i kontratave dhe kontrata në emër të Xhafa Travel. GOE i rekomanduar për kontratë

Xhafa travel dhe Dita travel shpk kane prezantuar referencën nr 489/24 te datës 10.10.2024 nga Medresa Alaudin për shërbime në emër te Dita travel shpk për tri vite 2021-2022 dhe 2023, ku është e potencuar vlera për tri vite në vlere 71.400.00 euro deri sa për një vite është e shprehur ne vlera për vite 23.800,00 euro. Ndërsa nëse hiqen vitet 2021 dhe 2022 vlerat për këto dy vite ne vlerën prej 47.600,00 euro mbetet vlera prej 23.800 euro, dhe kontrata tjetër për vitin 2024 e lidhur me datën 10.10.2024 me SHML Medresja Alaudin pa vlerë të përgjithshme e nëse shihen pozicionet 182 nxënës me vlerën 140 euro vlera e kontratës do të ishte 25.480.00 euro ku nuk janë transport por akomodim ne hotel për katër bujtje .

Kjo kontrate (edhe pse nuk është e natyrës se njëjte -transport I udhëtarëve - vlera e tërësishme do të ishte 49.280.00 Euro. Pra jo vlera e kërkuar minimum 63.825.00 Euro.

Dhe ne përfundim përmbushja e Kriterit të Kërkuara Kontrata te përfunduara në periudhën trevjeçare 2022-2023-2024 (36 muajt e fundit 30-08 .2022 – 30.09.2025) në vlerën prej 63.850 euro nuk është e plotësuar. Nuk ka Regjistër te Kontratave dhe nuk është e përmbushur Kërkesa nga FDT e as Dosjes se tenderit. AK ne Vendimin për Kërkesën për Ri Shqyrtim ka thënë se janë plotësuar kërkesat për Pune te kryera , gjë qe nuk rezulton shikuar faktet . Për me tepër Kontrata e lidhur me date 10.10.2024 nuk është e përfshirë ne Referencën e dhen nga Medresaj Alaudin e datës 10.10.2025 .

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Në lidhje me këtë kërkesë të DT-së, AK i ka pranuar vetëm referencat e anëtarit të grupit OE “Dita Travel”, ku këtë sqarim AK e kishte dhënë në përgjigje të kërkesës për ri shqyrtim, se janë marrë parasysh vetëm referencat e anëtarit të grupit “Dita Travel” Sh.p.k. Dhe pas shqyrtimit të referencave të “Dita Travel”, ekspertja shqyrtuese sqaron se ky anëtar i grupit ka bashkangjitur “Kontratë Shërbimi” e lidhur me datë 10.10.2024 në mes të AK Shkolla e Mesme e Lartë “Medreseja Alauddin” dhe OE “Dita” për realizimin e ekskursionit të maturantëve të vitit shkollor 2024/2025, ku çmimi për maturantë është 140 euro dhe numri i maturantëve është 182, me çmim të përgjithshëm prej 25,480.00 euro. Mirëpo, për këtë kontratë mungon referenca. Po ashtu, është bashkangjitur “Letër Referencë” ME NR. PROT. 489/24 e datës 10.10.2024, e lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë “Medreseja Alauddin”, në të cilën potencohet se gjatë viteve shkollore 2021 – 2022 dhe 2023, OE “Dita Travel” Sh.p.k. ka kryer shërbimet e ekskursionit të maturantëve të kësaj shkolle. Si shumë për tu paguar për shërbimet e marra për një vit kanë qenë 23,800.00 euro, ku shuma totale për tri vite ka qenë 71,400.00 euro. Mirëpo meqenëse kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë “në tri vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë”, atëherë për këtë referencë mund ti pranohet vitet 2022 dhe 2023 në shumë prej 47,600.00 euro (23,800.00 + 23,800.00). Mirëpo, për këtë referencë mungon kontrata. Duke pasur parasysh që kërkesa e AK-së ka qenë që për punët e kryera të dëshmohet me kontrata dhe referenca apo procesverbalet e pranimit teknik, AK gjatë vlerësimit të ofertave është dashur që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së, duke kërkuar nga grupi i OE të rekomanduar që të dorëzojnë kontratat aty ku janë referencat dhe aty ku janë kontratat të dorëzojnë edhe referencat konform kërkesës së DT-së. Pra, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon AK ka pranuar dokumentet qe nuk janë ne harmoni njëra me tjetrën . Libreza e autobusit te Xhafa Travel me tabelën 03-661-IH nuk ka certifikatë te kontrollës teknike .Certifikata është për Automjetin 03-590 IT dhe as njeri nuk kanë polisen e sigurimit . Derisa Anëtari i dyte Dita Travel shpk nga Podujeva nuk ka prezantuar

Certifikatat e Kontrollës teknike por ka dhënë një deklaratë të përpiluar nga vete Operatori që nuk ka relevance Shikuar Udhëzimin Administrativ nga MMPHI nr 10/2022 të datës 30.12.2022 ku nën 19 pika 1.2 përcakton që mjetet që bëjnë transportin e njerëzve janë të obliguar që kontrollat teknike të automjetit të bëhen çdo 6 muaj . Ky Udhëzim ka për bazë Ligjin nr 05/L-132 .

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të kërkesës së DT-së, thekson se AK kishte kërkuar:

Pas shqyrtimit të tenderit të OE të rekomanduar për kontratë, ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse në tenderin e OE të rekomanduar, konkretisht në dokumentin me titull “10.MJETET DHE SHOFERET GJAFA.pdf”, është bashkangjitur certifikata e regjistrimit të automjetit me targa 03-661-JH, kurse certifikatë mbi kontrollin teknik është bashkangjitur për një automjet krejt tjetër me targa 03-590-IT. Pra, AK në kërkesën e lartcekur kishte kërkuar që për mjetet e transportit të dëshmohej me librezë të regjistrimit të automjetit dhe certifikata të gjendjes teknike të automjetit jo më të vjetra se 6 muaj, kurse grupi i OE të rekomanduar nuk i kanë dorëzuar sipas kërkesës së AK.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues pretendon se Operatori Ekonomik Lideri nuk ka prezantuar Certifikatat shëndetësore siç parashihet për vozitës të Autobusëve por ka prezantuar nga QKMF Nene Tereza Kline formë jo zyrtare.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale 9.1 dhe 9.2, për shoferët ka kërkuar lejen e vozitjes dhe certifikatën e gjendjes shëndetësore të vozitësit me validitet jo më të vjetër se 6 muaj, kurse grupi i OE të rekomanduar për kontratë kanë bashkangjitur një certifikatë shëndetësore me nr. CM0201 dhe me numër serik 0027150, të lëshuar nga Specialisti i Qendrës së Mjekësisë Familjare me përshkrimin “konstatohet se personi është i aftë për punë”. Mirëpo, kjo certifikatë nuk i plotëson kërkesat ligjore të parapara për shoferët e autobusëve ashtu siç është rregulluar me Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) Nr.04/2013 Certifikatat Shëndetësore të nxjerr nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës. Në nenin 8 të këtij Udhëzimi, është bërë klasifikimi i certifikatave shëndetësore dhe janë përcaktuar komisionet mjekësore për lëshimin e secilit lloj të certifikatave. Në rastin konkret, për lëshimin e një certifikate shëndetësore që ka të bëjë me patent shofer, nën 3, par. 3.2, nën par. 3.2.1, 3.2.2, pika 3.2.2.1, 3.2.2.2, 3.2.2.3, 3.2.2.4 dhe 3.2.2.5, nevojitet një sërë analizash dhe duhet bërë ekzaminimi nga doktori i mjekësisë, oftamologu, psikiatri/neuropsikiatri, neurologu/neuropsikiatri dhe psikologu. Andaj, certifikata e tillë për mendimin e ekspertës shqyrtuese nuk e plotëson kërkesën e AK-së sepse bartja e njerëzve kërkon përgjegjësi dhe këtë përgjegjësi mund ta përcaktojnë vetëm profesionistët shëndetësor siç është paraparë me këtë udhëzim administrativ. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 5: OE ankues pretendon se anëtar i dytë e konzorciumit Dita Travel nuk ka dëshmi të vërtetimit nga Gjykata, kërkesa nga Neni 65 I LPP për pranueshmëri.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5: Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Pas shqyrtimit të tenderit të grupit të OE të rekomanduar për kontratë, ekspertja shqyrtuese vlerëson se lideri i grupit “Gjafa Travel” ka dorëzuar certifikatën e nxjerr nga Gjykata sipas kërkesës së AK-së, kurse për anëtarin e grupit “Dita Travel” AK kishte kërkuar sqarime shtesë,

ndërsa grupi i OE me datë 09.10.2025 kishte dorëzuar certifikatën e lëshuar nga Gjykata me nr. GJA.nr.7157/25 të datës 01.10.202. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Në mbështetje të asaj që është cekur si më lartë, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK nuk e ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të vendosura në dosje të tenderit, si dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Këtë konstatim ekspertja shqyrtuese e bazon në faktin se grupi i OE të rekomanduar ka bashkangjitur marrëveshjen “Deklarata për themelimin e grupit”, në të cilën janë përfshirë dy biznese tjera dhe të cilat nuk janë pjesë e grupit, ku tek pjesa e përgjegjësisë së secilit anëtar nuk përmenden fare bizneset që janë pjesë e grupit, marrëveshja e tillë është në kundërshtim me nenin 26 të Rregullores për Prokurim Publik. Andaj, rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe vlerësimi i ofertave të bëhet konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së, kurse ankesa e OE ankues është e bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ri tender – Transporti i nxeneseve te shkollave Fillore te Mesme te uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit:634-25-8397-2-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur tja fal besimin konstatimeve dhe rekomandimit të raportit të ekspertit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ri tender – Transporti i nxeneseve te shkollave Fillore te Mesme te uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit 634-25-8397-2-2-1, të anulohet njoftimi për dhenie te kontrates dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuara, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull Ri tender – Transporti i nxeneseve te shkollave Fillore te Mesme te uleta – Relacioni Dresnik – Kline – Dresnik me numër të prokurimit 634-25-8397-2-2-1 të kthehet ne rivlersim si dhe AK të veproj në harmonni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - RINORI TOURS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: